



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VIII  
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit  
P-094

Prishtinë, më 7 tetor 2024, ora 11:20  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 7 TETOR 2024

**Në mbledhje morën pjesë:** Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Enver Hoxhaj, Kujtim Shala dhe Bahrim Shabani, nënkryetarë të Kuvendit.

**Mungoi:** Saranda Bogujevci, nënkryetare e Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë:** Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Arben Gashi, Time Kadrijaj dhe Enis Kervan.

**Në mbledhje mori pjesë edhe** zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, Arben Loshi.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:** Stafi përgjegjës i Administratës së Kuvendit për mbështetje Kryesisë së Kuvendit, si dhe nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit, nga grupet parlamentare dhe nga organizatat.

Mbledhjen e kryesoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozim të kryetarit, Kryesia e plotësoi rendin e ditës me disa pika për shqyrtim nga Kryesia e Kuvendit.

Pastaj, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 28 mars 2024,
3. Seanca plenare, e shtyrë nga data e paraparë që të mbahet më 24 maj 2024,
4. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12 dhe 26 shtator 2024,
5. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
6. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave,
7. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 9 dhe 23 shtator 2024**

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 9 dhe 23 shtator 2024.

## **2. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 28 mars 2024**

Në lidhje me seancën e jashtëzakonshme, të mbajtur më 28 mars 2024, të papërfunduar, me pikën e vetme të rendit të ditës: Themelimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për procedurat e prokurimeve të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë, në ministri dhe në ndërmarrje publike qendrore, Kryesia për shkak të kalimit të afatit ligjor për themelimin e komisionit hetimor parlamentar, nxori këtë:

### **P Ë R F U N D I M**

1. Konstatohet kalimi i afatit ligjor për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për procedurat e prokurimeve të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë, në ministri dhe në ndërmarrje publike qendrore.
2. Hiqet nga procedura e mëtejme kërkesa e kryetarit të GP të PDK-së, Abelard Tahiri dhe shtatë (7) deputetëve të tjerë nga GP i PDK-së për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për procedurat e prokurimeve të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë, në ministri dhe në ndërmarrje publike qendrore (të parashtruar më 22.03.2024, me nr. 08/5175/Do-2296), për shkak të kalimit të afatit ligjor për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, ngase sipas nenit 4, paragrafi 5 të Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar, Komisioni nuk mund të themelohet gjatë gjashtë (6) muajve të fundit të një mandati të Kuvendit.
3. Seanca e jashtëzakonshme, e filluar më 28 mars 2024, me referencën L-VIII / SJ-153, konsiderohet e përfunduar, pasi që ka mbetur pa objekt, ngase pikë të vetme të rendit të ditës të papërfunduar e kishte vetëm themelimin e këtij komisioni hetimor parlamentar.

## **3. Seanca plenare, e shtyrë nga data e paraparë që të mbahet më 24 maj 2024**

Përsëri nuk u vendos për datën e mbajtjes së seancës së lartshënuar.

## **4. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12 dhe 26 shtator 2024**

Kryetari, pas diskutimeve, me konsensus, vendosi që vazhdimi i seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me pikat e papërfunduara, të mbahet të enjten, më 10 tetor 2024, në orën 11:00, me këtë:

### *Rend dite*

5. *Votimi për emërimin e shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore,*
6. *Votimi i Projektligjit nr. 08/L-309 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit, për programin e parë për "Financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe*

- rritjen e gjelbër”, në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,*
- 7. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-313 për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e grupit të Bankës Botërore,*
  - 8. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-314 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin “Energjia diellore fotovoltaike në KEK - Porta Globale”,*
  - 9. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor,*
  - 10. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë,*
  - 11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës,*
  - 12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-275 për rrugët,*
  - 13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës,*
  - 14. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-266 për gjendjen civile,*
  - 15. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore,*
  - 16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-306 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,*
  - 17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-311 për menaxhimin e resurseve ujore,*
  - 18. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028,*
  - 19. Votimi i Projekt-rezolutës për adresimin e gjetjeve të Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit,*
  - 20. Shqyrtimi i Projekt-deklaratës për raportet e Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës,*
  - 21. Shqyrtimi i Projekt-rezolutës për adresimin e çështjes së emigrimit të qytetarëve nga Republika e Kosovës,*
  - 22. Shqyrtimi i Projekt-rezolutës për tërheqjen e tri (3) projektligjeve nga shqyrtimi në Kuvend,*
  - 23. Shqyrtimi i Projekt-rezolutës për arratisjen e personave të dënuar - degradimi i institucioneve të sigurisë,*
  - 24. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-116,*
  - 25. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për vlerësimin e punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022,*
  - 26. Shqyrtimi i Raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2022,*
  - 27. Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për progresin mbi zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe reflektimin e Agjendës Transformuese të Kosovës në buxhet dhe politika qeveritare,*
  - 28. Themelimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, prej tyre, një nga komuniteti shqiptar dhe një nga komuniteti serb.*

## 5. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Përsëri nuk u vendos për mbajtjen e seancë së re plenare.

Ndërsa, në lidhje me themelimin e dy (2) komisioneve hetimore parlamentare, që ishin në procedurë, përkatësisht për radhitje në rendin e ditës të seancës së re plenare, Kryesia për shkak të kalimit të afatit ligjor për themelimin e komisioneve hetimore parlamentar nxori këto përfundime:

### I. P Ë R F U N D I M

1. Konstatohet kalimi i afatit ligjor për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar mbi përgjegjësitë ekzekutive të Ministrisë së Drejtësisë në raport me zjarret e dyshimta në Institutin e Mjekësisë Ligjore, zhdukjen e mostrave në rastin e Astrit Deharit dhe çdo veprimi e mosveprimi të kësaj ministrie që ka cenuar pavarësinë dhe përgjegjësitë ligjore të këtij instituti.
2. Hiqet nga procedura e mëtejme kërkesa e kryetarit të GP të PDK-së, Abelard Tahiri dhe gjashtë (6) deputetëve të tjerë nga GP i PDK-së për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar mbi përgjegjësitë ekzekutive të Ministrisë së Drejtësisë në raport me zjarret e dyshimta në Institutin e Mjekësisë Ligjore, zhdukjen e mostrave në rastin e Astrit Deharit dhe çdo veprimi e mosveprimi të kësaj ministrie që ka cenuar pavarësinë dhe përgjegjësitë ligjore të këtij instituti (të parashtruar më 12.12.2023, me nr. 08/4825/Do-2144), për shkak të kalimit të afatit ligjor për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, ngase sipas nenit 4, paragrafi 5 të Ligjit nr.03/L-176 për Hetim Parlamentar, Komisioni nuk mund të themelohet gjatë gjashtë (6) muajve të fundit të një mandati të Kuvendit.

### II P Ë R F U N D I M

1. Konstatohet kalimi i afatit ligjor për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për procesin e përllogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit, si dhe mënyrën dhe bazën e shlyerjes së borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
2. Hiqet nga procedura e mëtejme kërkesa e kryetarit të GP të PDK-së, Abelard Tahiri dhe shtatë (7) deputetëve të tjerë nga GP i PDK-së për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për procesin e përllogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit, si dhe mënyrën dhe bazën e shlyerjes së borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (të parashtruar më 23. 14. 2024, me nr. 08/5284/Do-2357), për shkak të kalimit të afatit ligjor për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, ngase sipas nenit 4, paragrafi 5 të Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar, Komisioni nuk mund të themelohet gjatë gjashtë (6) muajve të fundit të një mandati të Kuvendit.

## 6. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

*1. Shqyrtimi i mocionit përmbajtjesor: Projekt-rezolutë në lidhje me procesin e përllogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit, si dhe mënyrën dhe bazën e shlyerjes së borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*

Kryesia nuk e shqyrtoi mocionin e lartshënuar.

*2. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kanada, të Delegacionit të Përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

### V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Driton Hyseni dhe Xhavit Haliti, u lejohet udhëtimi zyrtar në Montreal (Kanada), prej datës 22 deri më 26 nëntor 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit, të vizave dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*3. Kërkesa e deputetes/kryetares së Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm, Fatmire Kollçaku, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri*

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

### V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Fatmire Kollçaku, Ardian Gola, Rrezarta Krasniqi, Fridon Lala, Albana Bytyqi, Arjeta Fejza dhe Vlora Dumoshi, si dhe Arijeta Rexhepi, nga stafi mbështetës i Grupit të Grave Deputete, u kompensohen mëditjet nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Tiranë (Shqipëri), prej datës 29 shtator deri më 1 tetor 2024.

*4. Kërkesa e deputetes Mimoza Kusari-Lila për lejimin e udhëtimit zyrtar në Itali*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

### V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Mimoza Kusari-Lila, i lejohet udhëtimi zyrtar në Gorizia (Itali), prej datës 19 deri më 21 tetor 2024.
2. Mëditjet për të lartshënuarën në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit mbulohen nga organizatori (OSBE).

*5. Kërkesa e deputeteve Blerta Deliu-Kodra dhe Hykmete Bajrami për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Deputeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Blerta Deliu-Kodra dhe Hykmete Bajrami, u lejohet udhëtimi zyrtar në Uashington D.C (Shtete të Bashkuara të Amerikës), prej datës 20 deri më 27 tetor 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarat në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*6. Kërkesa e deputetit Agon Batusha për ndryshimin e datave të udhëtimit zyrtar në Gjermani*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Agon Batusha, i mbulohen shpenzimet e biletës së udhëtimit për kthim nga Berlini (Gjermani) për në Kosovë, më 9 tetor 2024, nga udhëtimi zyrtar në Gjermani, prej datës 8 deri më 9 tetor 2024.

*7. Njoftimi i zëvendëskryetares së Komisionit për Integrim Evropian, Fjolla Ujkani, për pjesëmarrjen në Konferencën rajonale për forcimin e rolit të Parlamentit në procesin e integritit evropian, të mbajtur në Vlorë të Shqipërisë, nga data 10 deri më 13 shtator 2024*

Zëvendëskryetarja e Komisionit për Integrim Evropian, Fjolla Ujkani, e ka njoftuar Kryesinë e Kuvendit për pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përbërje: Fjolla Ujkani, zëvendëskryetare e Komisionit për Integrim Evropian dhe Time Kadrijaj, anëtare e Komisionit, në Konferencën rajonale për forcimin e rolit të Parlamentit në procesin e integritit evropian, me temën: “Procesi i udhëzuesit: Rruga përpara”, nga data 11 dhe 12 shtator 2024, në Vlorë të Shqipërisë.

Për më shumë, rreth pjesëmarrjes së delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në këtë Konferencë, bashkangjitur me njoftimin ishin:

- Raporti përmbledhës i pjesëmarrjes në Konferencën rajonale në Vlorë, më 10-13 shtator 2024.
- Dokumenti i rezultateve të takimit të nivelit të lartë të Rrjetit PARL në Konferencën rajonale “Procesi i udhëzuesit: Rruga përpara”, Vlorë, 10-13 shtator 2024.
- Parimet e mbikëqyrjes efektive parlamentare në procesin e integritit evropian.

*8. Kërkesa e deputetëve Ramush Haradinaj dhe Besnik Tahiri për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, i lejohet udhëtimi zyrtar në Çikago (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), prej datës 17 deri më 22 tetor 2024.
2. Mëditjet për lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Deputetit të Kuvendit të Republikës, Besnik Tahiri, i lejohet udhëtimi zyrtar në Çikago (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), prej datës 17 deri më 22 tetor 2024.
4. Shpenzimet e udhëtimit (biletës) dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën 3 (tre) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*9. Kërkesa e deputeteve Mimoza Kusari-Lila dhe Jeta Statovci për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës*

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Mimoza Kusari-Lila, Jeta Statovci, Armend Muja dhe Time Kadrijaj, u lejohet udhëtimi zyrtar në Uashington D.C (Shtete të Bashkuara të Amerikës), prej datës 21 deri më 27 tetor 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit (biletës), të akomodimit (qëndrimit, prej 21 – 26 tetor 2024) dhe mëditjet (prej 21 – 27 tetor 2024) për të lartshënuarat në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*10. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, Enver Hoxhaj, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Nënkyetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj, i lejohet udhëtimi zyrtar në Berlin (Gjermani), prej datës 10 deri më 13 nëntor 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit për dy net dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

## **Të ndryshme:**

### *1. Logoja e Kuvendit*

Kryetari deklaroi se Kryesia e Kuvendit, në pajtim me nenin 6, paragrafi 3, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator 2024 e ka miratuar Logon e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Por që, pas reagimeve në lidhje me ngjashmërinë me ndonjë logo tjetër, Kryesia e Kuvendit, më 23 shtator 2024 e ka trajtuar çështjen e logos së Kuvendit dhe ka konstatuar se e njëjta nuk duhet të këtë ngjashmëri me ndonjë logo tjetër, pavarësisht se logoja e përzgjedhur nga Juria profesionale nuk ka qenë identike me logon më të cilën është krahasuar.

Kryetari, tutje njoftoi se pas një takimi ndërmjet përfaqësuesve të Kuvendit dhe operatorit ekonomik fitues është konstatuar se logoja e përzgjedhur ka ngjashmëri me logon e krahasuar, pavarësisht se nuk janë identike dhe janë pajtuan që Kuvendi i Kosovës duhet të këtë logo, e cila nuk ka ngjashmëri me asnjë logo tjetër, ndërsa Operatori Ekonomik është pajtuar që t'i kthejë mjetet financiare të pranuar nga Kuvendi, si dhe ka kërkuar që t'i kthehet në pronësi e drejta e autorit të logos së propozuar.

Më pas, kryetari tha se Kuvendi i Kosovës do të zhvillojë procedurën e re për përzgjedhjen e logos së Kuvendit, por paraprakisht duhet të shfuqizohet Vendimi për miratimin e Logos. Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Pastaj, Kryesia mori këtë:

### **V E N D I M**

1. Shfuqizohet Vendimi i Kryesisë së Kuvendit nr. 08-V-854, datë 9 shtator 2024, për miratimin e Logos së Kuvendit të Republikës së Kosovës.
  2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që të zhvillojë procedurën e re për përzgjedhjen e Logos së Kuvendit, në pajtim me Vendimin e Kryesisë së Kuvendit, nr. 08-V-699, datë 12.02.2024.
- 2. Mocioni i gjashtë (6) deputetëve nga GP i PDK-së për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së*

Kryesia, në lidhje me mocionin e lartshënuar, nxori këtë:

### **P Ë R F U N D I M**

Kërkohet nga Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal që ta shqyrtojë mocionin për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, të parashtruar nga kryetari i GP-të PDK-së, Abelard Tahiri, i mbështetur edhe nga pesë (5) deputetë të tjerë dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.



Në fund, kryetari i GP Multietnik, Enis Kervan, në cilësinë e anëtarit të delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, në emër të kryesueses së delegacionit, nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevci, i parashtrori dy kërkesa për lejimin e udhëtimeve zyrtare të këtij delegacioni, për pjesëmarrje në aktivitetet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

*1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës*

Kryesia e shtyri shqyrtimin e kërkesës së lartshënuar.

*2. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Serbi*

Kryesia, pas diskutimeve në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Saranda Bogujevci, Arben Gashi, Jeta Statovci, Armend Muja, Vlora Dumoshi dhe Erxhan Galushi, si dhe Agime Gashaj, këshilltare e nënkryetares së Kuvendit, znj. Bogujevci, u lejohet udhëtimi zyrtar në Beograd (Serbi), prej datës 10 deri më 11 tetor 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen në orën 12:13 minuta.

**Glauk Konjufca**

---

Kryetar i Kuvendit

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*